

PRAKTIKAT LEGJISLATIVE NË VENDET E RAJONIT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DHE HABITATEVE NATYRORE



Dr. Irena Dule
Av. Dorian Matlija

Treguesi i lëndës

1. HYRJE	3
2. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE	4
3. STANDARDET E VENDOSURA NGA BE	5
3.1 Direktivat kryesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit	6
3.2. Monitorimi dhe informacioni mjedisor	8
4. ZONAT E MBROJTURA	9
4.1 Praktikat nw rajon	9
4.2 Natura 2000	9
4.3 Rrjeti Emerald	10
5. PRAKTIKAT E KOMISIONIT EVROPIAN DHE GJYKATËS EVROPIANE PËR DREJTËSI (LUKSEMBURG) PËR GARANTIMIN E RESPEKTIMIT TË DIREKTIVAVE	10
5.1 Komisioni Evropian i kërkon Hungarisë dhe Rumanisë të sigurojnë mbrojtjen e habitateve të jetës së egër	11
5.2 Komisioni Evropian i kërkon Maltës respektimin e Direktivës së Shpendëve	12
5.3 Komisioni Evropian dërgon Bullgarinë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë për dështim në mbrojtjen e specieve në rrezik zhdukjeje	12
5.4 Komisioni Evropian paralajmëron Greqinë për mangësitë në mbrojtjen e natyrës	14
5.5 Komisioni i kërkon Hungarisë të respektojë legjislacionin e BE-së për vlerësimet e ndikimit në mjedis	15
6. AKSESI NË DREJTËSI. PRAKTIKA TË MIRA DHE RASTE SUKSESI	15
6.1 Praktikat legjislative të aksesit në gjykatë në vende të ndryshme	16
6.1.1 Sllovakia	16
6.1.2 Kroacia	17
6.1.3 Estonia	18
6.1.4 Rumania	20
6.1.5 Sllovenia	21
6.2 Çështje nga praktika	22
6.2.1 Ndalimit i ndërtimit të HEC-eve në Parkun Kombëtar të Mavrovës	22
6.2.1 Rasti i turbinave të erës pranë zonave të mbrojtura (Hungari)	24
7. KONKLUSIONE & REKOMANDIME	25
8. BIBLIOGRAFIA	28

1. HYRJE

Mbrojtja e mjedisit po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një nevojë imediate me objektivin për të ndaluar, kontrolluar dhe riparuar dëmtimin që i vjen mjedisit nga veprimtaria ekonomiko-sociale e njeriut. Shoqëria po e kodifikon gjithnjë e më shumë këtë të drejtë, duke përfshirë aspekte teknike dhe masa të shumta për të arritur qëllimin e mësipërm.

Koncepti i ligjeve për mjedisin si një degë e veçantë është një zhvillim i shekullit XX.¹ Deri në fund të këtij shekulli legjislati i mjedisit u bë komponent i peizazhit juridik në të gjitha kombet e zhvilluara të botës, si dhe shumë vendeve në zhvillim. Ndikimi më i madh ndodhi për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit dhe miratimit të një serie konventash ndërkombëtare, të cilat hodhën bazat juridike për të zhvilluar më pas legjislacionet vendase.

E drejta ndërkombëtare e mjedisit është e fokusuar te kontrolli i ndotjes dhe i shfrytëzimit të burimeve natyrore brenda një kornize të zhvillimit të qëndrueshëm. Ajo është degë e së drejtës publike ndërkombëtare dhe mbulon tema të tilla si popullsia, biodiversiteti, ndryshimi i klimës, varfërimi i shtresës së ozonit, substancat toksike, ndotja e ujit, ajrit, tokës, detit, ruajtja e burimeve detare, ruajtja nga shkretëtirizimi dhe dëmtimet që vijnë nga veprimtaria bërthamore.²

Ndër konventat që kanë ndryshuar në mënyrë rrënjësore pamjen e legjislacioneve vendase janë Konventa e Aarhus me fokus te informimi mjedisor, konsultimi publik dhe adresimi në gjykatë i mungesës së njoftimit dhe konsultimit publik; Konventa e Bernës me fokus te mbrojtja e biodiversitetit; Konventa e Ramsar me fokus te mbrojtja e ligatinave; Konventa e Espoos me fokus te vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar; Konventa e Firences me fokus te mbrojtja e peisazheve natyrore, etj.

Shqipëria dhe të gjitha vendet e rajonit të Evropës Juglindore i kanë nënshkruar konventat më të rëndësishme nga ato të përmendura më lart dhe kanë marrë masa për të rishikuar, pasuruar e përafruar legjislacionin e tyre si dhe për ta përshtatur me parashikimet e këtyre konventave.

Nëse konsiderojmë edhe interesin për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, standardet mjedisore janë bërë gjithmonë e më të kërkuara dhe më strikte në vendet e rajonit. Përputhja me detyrimet mjedisore është në nga paketat e detyrimeve më të rëndësishme që shtetet duhet të përmbushin në procesin e anëtarësimit. Kjo kërkon shpërndarjen e burimeve materiale dhe njerëzore. Instrumentat e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), duhet t'i mundësojnë planifikuesve dhe vendimarrësve të parashikojnë efektet e politikave, planeve, programeve dhe projekteve të tyre mbi mjedisin dhe të vlerësojnë lidhjen me ekonominë dhe shoqërinë.

Para së gjithash, strategjitë ekzistuese duhet të implementohen e konsiderohen dhe strategjitë që miratohen në vazhdim duhet të jenë realiste, të harmonizuara dhe gjithëpërfshirëse, që të marrin në konsideratë studimet, planet dhe projektet ekzistuese të fushës. Këto strategji nevojiten të jenë të detyrueshme. Vendet e Ballkanit përfundimor po përballen me disa

¹ Shih R. Lazarus, *The Making of Environmental Law* (Cambridge Press 2004); P. Gates, *History of Public Land Law Development*.

² Lakshman D Guruswamy, *International Environmental Law in a Nutshell* (West, 5th ed, 2017).

problematika të cenimit të mjedisit në vazhdimësi nga ndërtimi i infrastrukturave që prodhojnë energji, subjekte urbanizuese massive turistike dhe investime të karaktereve të tjera.

Mjedisi nuk ka qenë prioritet në axhendën e elitave partiake dhe autoriteteve politike në këto vende. Margjinalizimi politik i çështjeve të mjedisit është reflektuar në strategjinë e fundit për vendet ballkanike, hartuar nga BE. Për më tepër raportohet se në implementimin e projekteve të ndryshme në rajon gjenden plane të pjesshme për investime të papërshtatshme që nuk marrin parasysh strategjitë, planet ekzistuese, apo kërkesat ligjore. VNM-të bëhen për disa prej projekteve sa për të përmbushur procedurën ligjore. Vlen të theksohet se në përgjithësi legjislacioni ynë mjedisor është i një niveli të mirë dhe deri diku i përafëruar me Direktivat e Mjedisit të BE-së, pak a shumë si në vendet e rajonit, pjesë kjo e zhvilluar në vijim.

Përvec vlerësimeve të përgjithshme lidhur me legjislacionin e përafëruar, nga praktikat vendase evidentohen një sërë problematikash që hasin organizatat dhe publiku dhe që nuk gjejnë adresim siç janë çështjet e informimit, konsultimit publik, mbrojtjes efektive të specieve dhe habitateve dhe legjitimitit në gjykatë.

Në vijim në pjesën e parë të këtij raporti jepet një tablo e Konventave dhe Direktivave dhe qëndrimin e vendit tonë dhe vendeve të rajonit lidhur me to. Në pjesën e dytë trajtohen se disa praktika dhe qëndrime të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane për Drejtësi lidhur me vendet anëtare të BE, kur janë vënë në diskutim çështje mjedisore dhe shkelje të direktivave në këtë fushë. Në pjesën e tretë janë adresuar këto problematika në vendet e rajonit duke u fokusuar te legjislacioni, por edhe praktika gjyqësore e tyre. Raporti mbyllet me disa konkluzione dhe rekomandime me fokus përmirësimin e legjislacionit dhe praktikës vendase.

2. KONVENTAT NDËRKOMBËTARE

Ashtu si Shqipëria, edhe vendet e rajonit kanë nënshkruar të gjitha konventat e rëndësishme që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit.

Një konventë me rëndësi, e cila nuk rezulton të jetë miratuar nga Shqipëria, por është miratuar nga të gjithë vendet e rajonit, është Konventa Evropiane për Peizazhet (Konventa e Firences, një konventë e Këshillit të Evropës), e cila është hartuar në vitin 2000.

Kjo konventë do të ndihmonte të mbronte sitet natyrore që kanë rëndësi për peizazhin që ofrojnë dhe për monumentet natyrore e kulturore. Nuk raportohen arsye pse Shqipëria nuk është bërë ende pjesë e familjes nënshkruese të kësaj konvente, ndërkohë që një nga shqetësimet e ngritura shpesh në çështjet mjedisore është cenimi i peisazheve natyrore nga ndërtimet, sidomos në zonat e bregdetit.

Në tabelën në vijim pasqyrohen konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga rajoni.

Figure 1: Lista e konventave dhe marrëveshjeve të nënshkruara nga vendet e rajonit

Konventa ndërkombëtare	Autoriteti	Shqipëria	Bosnja	Kroacia	Maqedonia V.	Mali i Zi	Serbia	Sllovenia
Konventa për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare veçanërisht si Habitata të Shpendëve të Ujit (Ramsar), 1971	Ramsar Secretariat	•	•	•	•	•	•	•
Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore (Konventa për Trashëgiminë Botërore), 1972	UNESCO	•	•	•	•	•	•	•
Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES), 1973	UNEP	•	•	•	•	•	•	•
Konventa për Ruajtjen e Mjedisit Detar dhe Rajoneve Bregdetare të Mesdheut (Konventa e Barcelonës), 1976	UNEP	•	•	•		•		•
Konventa për Ruajtjen e Specieve Shtegtare (CMS), 1979	UNEP	•	•	•	•	•	•	•
Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror në Evropë (Konventa e Bernës), 1979	Këshilli i Evropës	•	•	•	•	•	•	•
Marrëveshja për Ruajtjen e Popullatave të Lakuriqëve të Natës Evropiane (EUROBATS), 1991	UNEP	•		•	•	•	1	•
Konventa për Diversitetin Biologjik (CBD), 1992	UN	•	•	•	•	•	•	•
Marrëveshja Kuadër e OKB për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), 1992	UN	•	•	•	•	•	•	•
Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujrave Ndërkufitarë dhe Liqeneve Ndërkombëtare, 1992	UNECE	•	•	•	•		•	•
Konventa e OKB për Luftën ndaj Shkretëtirimit (UNCCD), 1994	UN	•	•	•	•	•	•	•
Marrëveshja për Ruajtjen e Shpendëve të Ujit Migratorë Euroaziatikë (AEWA), 1995	UNEP	•		•	•	•	2	•
Protokolli për Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Diversitetin Biologjik në Detin Mesdhe (SPA/BD Protocol), 1995	UNEP	•		•		•		•
Marrëveshja për Ruajtje e Cetaceve në Detin e Zi, Detin Mesdhe, dhe Zonës Fqinje të Oqeanit Atlantik (ACCOBAMS), 1996	UNEP	•		•		•		•
Konventa për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen Publike në Vendimarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështjet Mjedisore (Konventa e Aarhus), 1998	UNECE	•	•	•	•	•	•	•
Protokolli i Kartagjenës për Biosigurinë, I CBD, 2000	UN	•	•	•	•	•	•	•
Konventa Evropiane e Peisazheve, 2000	Këshilli i Evropës		•	•	•	•	•	•

3. STANDARDET E VENDOSURA NGA BE

Njerëzit në mbarë Evropën kanë shprehur shqetësimin e tyre për humbjen e biodiversitetit. Në përgjigje të këtij shqetësimi në rritje, qeveritë e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian i vunë vetes synimin ambicioz për të ndaluar humbjen dhe për të rikthyer biodiversitetin në Evropë deri në vitin 2020.

3.1 Direktivat kryesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit

*Direktiva e Shpendëve*³ dhe *Direktiva e Habitave*⁴ janë në themel të legjislacionit evropian për ruajtjen e natyrës. Këto direktiva përfaqësojnë iniciativën me shtrirjen më të gjerë dhe më ambicioze të ndërmarrë ndonjëherë për të ruajtur trashëgiminë natyrore të Evropës.

Të dyja Direktivat u mundësojnë të 28 vendeve anëtare të punojnë së bashku brenda së njëjtës kornizë të fortë ligjore, në mënyrë që të mbrohen llojet dhe habitatet më të cënueshme brenda BE-së, pavarësisht nga kufijtë politikë apo administrativë. Direktiva e Shpendëve e cila është miratuar në vitin 1979, synon të mbrojë të gjithë shpendët e egër dhe habitatet e tyre më të rëndësishme. Direktiva e Habitave u miratua në vitin 1992 duke paraqitur masa të ngjashme me atë të shpendëve, por e shtrin mbulimin e saj mbi bimë e gjallesa të tjera të rralla, të kërcënuara ose endemike.

Objekti i përgjithshëm i të dy direktivave është të sigurojë që llojet dhe habitatet që ato mbrojnë, ruhen apo rehabilitohen drejt një statusi të favorshëm ruajtjeje. Direktivat synojnë të garantojnë që llojet dhe habitatet të rehabilitohen mjaftueshëm për tu mundësuar atyre mbijetesën afatgjatë.

Direktiva e Shpendëve dhe ajo e Habitave u kërkojnë vendeve anëtare të zbatojnë dy grupe kryesore masash:

- grupi i parë i masave u kërkon vendeve anëtare të caktojnë regjime të rrepta mbrojtjeje për gjithë shpendët e egër të Evropës si dhe llojet e tjera të rrezikuara, të listuar në Aneksin IV të Direktivës së Habitave, si brenda dhe jashtë zonave Natura 2000.
- grupi i dytë i masave kërkon përcaktimin e zonave kryesore për ruajtjen e llojeve dhe habitave të listuara në Aneksin I dhe II të Direktivës së Habitave dhe Aneksin I të Direktivës së Shpendëve, si dhe për shpendët shtegtarë. Së bashku, këto zona janë pjesë e një rrjeti ekologjik koherent të zonave natyrore, njohur si Rrjeti Evropian Natura 2000.

Sipas Direktivës së Habitave, çdo vend anëtar fillimisht identifikon dhe propozon për ruajtje zona të rëndësishme për ruajtjen e specieve dhe habitave që gjenden në territorin e tyre. Pas kësaj, Komisioni Evropian, me ndihmën e vendeve anëtare, Agjencisë Evropiane të Mjedisit dhe ekspertëve shkencorë, përzgjedh zonat me interes për komunitetin. Nëse lista kombëtare konsiderohet e pamjaftueshme, vendet anëtare duhet të propozojnë zona të tjera për të plotësuar rrjetin. Pas përzgjedhjes, Zonat me Interes për Komunitetin bëhen pjesë e Rrjetit Natura 2000.

Përzgjedhja e zonave sipas Direktivës së Shpendëve bëhet pak më ndryshe: zonat klasifikohen nga vendet anëtare dhe pas vlerësimit përfshihen direkt në Rrjetin Natura 2000.

Përveç përzgjedhjes së zonave për rrjetin Natura 2000, e cila bëhet mbi kritere tërësisht shkencorë, masat e ruajtjes sipas të dyja direktivave duhet të marrin parasysh kushtet ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe karakteristikat rajonale dhe lokale të vendeve në fjalë.

³ Direktiva 79/409/EEC është ligji më i hershëm i legjislacionit të BE, e amenduar në 2009 ajo është sot Direktiva 2009/147/EC

⁴ Direktiva e Habitave 92/43/EEC u miratua në 21 Maj 1992

Për të kontrolluar nëse masat e marra po arrijnë synimet e tyre, vendet anëtare monitorojnë progresin dhe raportojnë në Komisionin Evropian çdo gjashtë vjet mbi statusin e ruajtjes së specieve dhe habitateve me rëndësi Evropiane të pranishme në territorin e tyre. Më pas, Komisioni Evropian i bashkon këto informacione për të përcaktuar tendencën e përgjithshme për secilën specie dhe habitat, në të gjithë BE-në, dhe nëse ato kanë arritur apo janë drejt arritjes së statusit të favorshëm të ruajtjes.⁵

Direktivat e Shpendëve dhe Habiteteve mbështesin parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të integruar. Qëllimi i tyre nuk është të ndalojnë të gjitha aktivitetet ekonomike brenda zonave Natura 2000, por të gjejnë mënyrat që këto aktivitete të kryhen duke ruajtur dhe mbështetur llojet dhe habitatet e vlefshme që ndodhen në to, si dhe duke ruajtur shëndetin e përgjithshëm të ekosistemeve natyrore në të mirë të gjithë shoqërisë.⁶

Në vendet e rajonit rezulton se shumë instrumenta të parashikuar nga Direktivat janë bërë pjesë e legjislacioneve. Në ndryshim nga vendet e rajonit, Shqipëria ka miratuar një ligj për zonat e mbrojtura, i cili hedh edhe bazat për caktimin e zonave të veçanta të ruajtjes.

Me ligjin nr. 46/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, Shqipëria plotësoi më tej kuadrin ligjor duke përafuar legjislacionin vendas me Direktivën e Habiteteve dhe *pjesërisht* me Direktivën e Shpendëve, duke propozuar ndryshime specifike lidhur me helmimin, pesticidet (PMB), barnat veterinare dhe metodën me karrem helmues, rrjedhimisht ndryshimet i afrohen edhe rregullimeve ligjore që janë miratuar tashmë në pothuajse të gjithë vendet e rajonit. Sipas ligjvënësit, ky ligj ka si qëllim të bëjë disa ndryshime e plotësime në ligjin në fuqi nr.10006/2008 për faunën e egër, në mënyrë që të adresohen ndryshimet e ndodhura si rezultat i reformës territoriale, ndryshimet në menaxhimin e pyjeve dhe organeve respektive të shërbimit pyjor në nivel vendor të vitit 2016, si dhe të reflektohet avancimi me transpozimin e dy direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës, direktivës nr.92/43/EEC “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër”, të ndryshuar, dhe të direktivës nr.2009/147/EC, “Për konservimin e shpendëve të egër”.

Mbetet ende që legjislacioni ynë të përafrohet plotësisht me Direktivën.

Direktiva nr 85/337/EEC për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis e ndryshuar është kodifikuar me Direktivën 2011/92/EU, e ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU. Kjo Direktivë ka për qëllim të sigurojë që projektet të cilat mund të kenë një efekt të rëndësishëm në mjedis, vlerësohen në mënyrë adekuate përpara se ato të miratohen. Prandaj, para se të merret ndonjë vendim që të lejojë një projekt të tillë, të veprojë, ndikimet e tij të mundshme në mjedis duhet të identifikohen dhe të vlerësohen. Zhvilluesit pastaj mund të rregullojnë projektet për të minimizuar ndikimet negative para se ato të ndodhin, ose autoritetet kompetente mund të përfshijnë masa lehtësuese në miratimin e projektit.

Direktiva është përafuar plotësisht me ligjin nr 10440, dt 07.07.2012 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

Direktiva 2001/42/EC për Vlerësimin Strategjik Mjedisor është një direktivë tjetër e Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së mjedisit, e cila rregullon planet dhe programet që mund të

⁵ http://www.natura.al/contentfiles/docs/uploadfilesNatura2000_The_EU_Birds_and_Habitats_Directives_AL_final.pdf, faqe 15.

⁶ Po aty, faqe 27.

prodhojnë efekte mjedisore. Procedura e vlerësimit strategjik mjedisor duhet të tregojë, përshkruaj dhe vlerësojë të gjitha ato efekte që mund të ndodhin në mjedis kur zbatohen planet dhe programet, të pasuara me të gjitha zgjidhjet alternative që mund të realizohen në përmbushje të planeve, programeve dhe objektivave mjedisore.

Kjo direktivë është përfshirë plotësisht me ligjin nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”.

3.2. Monitorimi dhe informacioni mjedisor

Lidhur me monitorimin dhe informacionin mjedisor, vendet e rajonit kanë praktika të ndryshme. Nga praktikatat e mira vlen për t’u përmendur ajo e Kroacisë e cila ka disa regjistra dhe një pjesë e mirë e të dhënave janë të hapura për publikun. Një pasqyrë e situatës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Figure 2: Sistemet e monitorimit të mjedisit dhe administrimit të të dhënave në rajon

Shteti	Databasa	Statusi
Shqipëria	Sistemi i Monitorimit të Mjedisit	Jo funksional
Bosnja	Nuk ka	
Kroacia	Sistemi i Informimit për Mbrojtjen e Natyrës	
	CRO Fauna	Funksional, pjesërisht publik
	CRO Flora	Funksional, pjesërisht publik
	CRO Speleo	Në ndërtim
	CRO Habitats	Funksional, publik
	Natura 2000	Funksional, publik
	Zonat e Mbrojtura	Funksional, publik
Maqedonia e V.	Sistemi Kombëtar i Informacionit për Biodiversitetin	Jo funksional
Mali i Zi	Sistemi Kombëtar i Informacionit për Mjedisin	Në ndërtim
	Databasa për Zonat e Mbrojtura	Në ndërtim
Serbia	Regjistri Qendror i Zonave të Mbrojtura Natyrore të Serbisë	Funksional, jo publik
	Sistemi Kombëtar i Informacionit për Mjedisin	Funksional, pjesërisht publik
Slovenia	Atlas i Ruajtjes së Natyrës	Funksional, pjesërisht publik

Një direktivë që vendos standarde të mira për informacionin mjedisor është Direktiva 2007/2/KE e Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 mars 2007 "Për ngritjen e një infrastrukture për informacionin hapësinor në Komunitetin Europian (INSPIRE)". Vendet e rajonit që janë anëtarë të BE-së e kanë implementuar këtë direktivë duke hedhur të dhëna në databazë dhe duke pasuruar portalet e tyre vendase. Në faqen zyrtare të BE-së lidhur me këtë direktivë vihet re se janë përfshirë edhe vende të tjerë të rajonit që nuk janë anëtarë si Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Kroacia përbën një shembull të mirë të publikimit të këtyre të dhënave, të hapura për publikun.


Shqipëria ka bërë përpjekje për të përfshirë këtë direktivë me anën e ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”. Megjithatë, ky ligj ka përfshirë vetëm pjesërisht dhe në portalin e ASIG vihet re se mungojnë të dhëna të rëndësishme sipas përcaktimeve të direktivës.

4. ZONAT E MBROJTURA

4.1 Praktikë në rajon

Në lidhje me sipërfaqen e zonave të mbrojtura, Shqipëria rezulton se ka një raport të mirë të zonave të mbrojtura me sipërfaqen totale të vendit (mbi 16%). Situata paraqitet në grafikun në vijim:

Figure 3: Sipërfaqet e zonave të mbrojtura në raport me sipërfaqen totale në vendet e rajonit



Në përgjithësi zonat e mbrojtura administrohen nga organe shtetërore, por nuk mungojnë në rajon edhe praktika ku zonat e mbrojtura administrohen me PPP ose nga OJF. Rasti më interesant është ai i Kroacisë, e cila menaxhimin e peizazhit të rëndësishëm të Gajnes ia ka besuar një OJF-je. Në Gajna, OJF dhe Këshilli lokal e menaxhojnë zonën në bashkëpunim dhe përbën një nga rastet e suksesshme të qeverisjes së ndarë me publikun.⁷

Në Slloveni konstatohet se në administrim thirret me raste edhe komuniteti lokal, pavarësisht se i paorganizuar në OJF.⁸

4.2. Natura 2000

Në lidhje me rrjetin Natura 2000, Shqipëria është ende në fazë të identifikimit të zonave, përmes një projekti IPA. Vendet e rajonit, përveç atyre që janë anëtarë të BE-së, ndodhen në të njëjtën fazë si Shqipëria. Më përparim vihet re në Serbi ku janë identifikuar 43 zona dhe në Bosnje ku janë identifikuar 122 zona, pavarësisht se Bosnja nuk është ende një vend kandidat.

⁷ https://www.sogde.org/wp-content/uploads/2018/12/benes_iris_kosovo_10_18.pdf, faqe 4

⁸ Kus Veenvliet and Sovinc, 2009

4.3. Rrjeti Emerald

E njëjtë paraqitet edhe situata me rrjetin Emerald. Të gjithë vendet e rajonit kanë propozuar zona, p.sh. Shqipëria 25 zona, Bosnja 29, Mali i Zi 32, Maqedonia e Veriut 35, apo Serbia zona.

Në lidhje me speciet e rrezikuara raportohet se çdo vend i rajonit ka hartuar Plan Veprimi për to. Për shembull, Shqipëria ka hartuar 7 Plane Veprimi përfshirë për Pelikanin Kacurrel (2015), për Ariun e Murrme (2007), Rrëqebullin (2007), Breshkën e Ujit (2013), etj.

1. Plan Veprimi për Ruajtjen e Ariut (*Ursus arctos*);
2. Plan Veprimi për Ruajtjen e Rrëqebullit (*Lynx lynx*);
3. Plan Veprimi për Ruajtjen e *Phalacrocorax pygmeus*;
4. Plan Veprimi për Ruajtjen e Cetaceve;
5. Plan Veprimi për Ruajtjen e Livadheve oqeanike *Posidonia*;
6. Plan Veprimi për Ruajtjen e breshkës së detit dhe habitatit të saj natyror;
7. Plan Veprimi për Ruajtjen e Pelikanit Kacurrel (*Pelecanus crispus*).

5. PRAKTIKAT E KOMISIONIT EVROPIAN DHE GJYKATËS EVROPIANE PËR DREJTËSI (LUKSEMBURG) PËR GARANTIMIN E RESPEKTIMIT TË DIREKTIVAVE

Në vijim jepen disa praktika të Komisionit Evropian me shtete anëtare të pëzgjedhura për efekt të këtij studimi sipas direktivave të BE-së që synojnë të mbrojnë habitatet dhe shpendët.

Në parantezë shpjegohet se si funksionon dhe vepron Komisioni Evropian në lidhje me këto çështje.

Komisioni ka fuqinë të ndërmarrë veprime juridike kundër një shteti anëtar që nuk respekton detyrimet e tij, sipas ligjit të Komunitetit, sipas nenit 258 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Procedura e shkeljes fillon me një paralajmërim të parë me shkrim ("Letër e njoftimit zyrtar") drejtuar Shtetit Anëtar në fjalë, i cili duhet të përgjigjet brenda dy muajve.

Nëse Komisioni nuk është i kënaqur me përgjigjen, kjo letër e parë mund të pasohet nga një paralajmërim me shkrim përfundimtar ("Opinion i argumentuar") i cili shpjegon qartë shkeljen, dhe duke i bërë thirrje Shtetit Anëtar që të respektojë brenda një periudhe të caktuar, zakonisht dy muaj.

Mosveprimi i paralajmërimit me shkrim përfundimtar mund të rezultojë në një thirrje në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë (Gjykata e Luksemburgut). Nëse Gjykata vendos kundër Shtetit Anëtar, atëherë ky i fundit duhet të marrë masat e nevojshme për të zbatuar kërkesat e vendimit.

Nëse, pavarësisht vendimit, një shtet anëtar ende nuk arrin të veprojë në përputhje me të, një raund i mëtejshëm i procesit të shkeljes fillon sipas nenit 260 të Traktatit, por këtë herë me vetëm një paralajmërim me shkrim. Raundi i dytë përfundimisht mund të rezultojë në ndëshkime financiare për Shtetin Anëtar në fjalë.

Në vijim paraqesim disa çështje të prezantuara para Gjykatës së Drejtësisë Evropiane nga ana e Komisionit Evropian kundër shteteve anëtare të BE ku janë gjetur shkelje të Direktivës.

5.1 Komisioni Evropian i kërkon Hungarisë dhe Rumanisë të sigurojnë mbrojtjen e habitateve të jetës së egër.⁹

Më 31 Maj 2012, Komisioni i kërkoi Hungarisë dhe Rumanisë të përmirësojnë mbrojtjen e habitateve. Të dy shtetet kishin lejuar aktivitete ose zhvillime në vende me ndjeshmëri mjedisore pa bërë më parë një vlerësim të duhur të impaktit në mjedis. Mbi rekomandimin e Komisionerit të Mjedisit, Komisioni nisi një opinion të arsyetuar Hungarisë dhe një tjetër opinion të arsyetuar Rumanisë ku i kërkoi atyre të implementonin në mënyrën e duhur legjislacionin për mbrojtjen e habitateve. Nëse Hungaria dhe Rumania dështonin të zbatonin sa më sipër brenda dy muajve, Komisioni mund të referonte këtë çështje në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.

Në rastin e Hungarisë ankesa kishte të bënte me prerjen e papërshtatshme të pemëve në pyllin 'Sár-éger' – pjesë integrale e faqes Natura 2000 'Csaholc-Garbolc'- që rezultoi në humbje të ndjeshme të habitatit prioritar. Pas komunikimit me autoritetet Hungareze, Komisioni doli në përfundimin se ato nuk kishin bërë një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis në mënyrën e duhur para kësaj veprimtarie dhe as nuk kishin marrë masa për të kompensuar dëmet që do të shkaktoheshin.

Në këtë rast u shkel direktiva e habitateve e cila është krijuar mbështetur në dy shtylla: (1) Rrjeti i Natyra 2000 të zonave të mbrojtura dhe (2) një sistem strikt të mbrojtjes së specieve. Çdo vend anëtar ka dizenjuar faqen *Natura 2000* në ndihmë të konservimit të specieve dhe habitateve të rralla, të pranishme në territorin e tyre.

Në rastin e Rumanisë, autoritetet dështuan të bënin një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis të plotë dhe gjithëpërfshirës për një investim turistik të miratuar në Sulina në Detin e Zi. Komisioni i dërgoi Rumanisë një njoftim zyrtar në Maj 2010. Përgjigja e Rumanisë nuk mbuloi të gjitha shqetësimet e Komisionit dhe letra u ndoq nga opinion i parë i arsyetuar në Janar 2011. Sqarime të mëtejshme u kërkuar për procedurën e aplikimit pasi konstatoheshin elementë kontradiktorë në dokumentacionin shoqërues, veçanërisht në versionin përfundimtar të studimit të ndikimit të investimit në habitatet e mbrojtura. Direktiva e Habitaveve mbron mbi 1000 kafshë dhe specie dhe mbi 200 tipe habitatesh të tilla si tipe të ndryshme pyjesh, livadhesh dhe ligatinash me rëndësi Evropiane Mbi 25.000 zona janë përfshirë në rrjetin Natura 2000, që mbulon zona substanciale; pothuajse 1/5 e tokës në Evropë dhe një pjesë të rëndësishme të detit që e rrethon. Disa janë të vendosura në zona të largëta por shumë krijojnë pjesë integrale të fshatrave dhe përmbajnë lloje të ndryshme habitatesh, zona zbutëse të impaktit dhe elementë të tjerë të peizazhit.

⁹ https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-539_en.htm?locale=en

5.2 Komisioni Evropian i kërkon Maltës respektimin e Direktivës së Shpendëve¹⁰

Më 27 Shkurt 2012, Komisioni i kërkoj Maltës të përmirësonte mbrojtjen e shpendëve që bllokohen në ishull gjatë vjeshtës. Që kur Malta iu bashkua Bashkimit Evropian në 2004, lejoi shtegtimin e katër llojeve shpendësh që mbroheshin nga ligjet e Bashkimit Evropian: turtulli, shkurta, gjelaci pikalosh ngjyrë ari dhe tusha këngëtare. Sipas rekomandimit të Komisionerit të Mjedisit, Komisioni dërgoi një opinion të arsyetuar duke i kërkuar Maltës që të implementojë legjislacionin e mbrojtjes së shpendëve. Nëse Malta dështonte të përgjigjej brenda dy muajve, Komisioni mund të çojte çështjen para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Në Evropë një pjesë e madhe e shpendëve mbrohen nga Direktiva e Shpendëve, dhe bllokimi me metodat në shkallë të gjerë ose me mënyrë joselektive të kapjes, siç janë rrjetat, janë përgjithësisht të ndaluara dhe mund të praktikohen ligjërisht vetëm mes shmangies nga respektimi i Direktivës. Përrjashtime mund të ketë vetëm nëse nuk ka një alternativë të zbatueshme, nëse shteti anëtar respekton kushtet dhe kërkesat e rrepta të përcaktuara në nenin 9 të Direktivës, dhe nëse mund të provojë para Komisionit që e kanë bërë një gjë të tillë.

Në Qershor 2011 Komisioni i dërgoi Maltës një njoftim zyrtar për zbatimin e gabuar të shmangieve që lejojnë bllokimin e shpendëve. Komisioni konsideroi që Malta dështoi të paraqesë prova të mjaftueshme për të vërtetuar se veprimet e saj për të ulur bllokimin respektonin të gjitha kushtet e nevojshme të Direktivës dhe në veçanti rregullat në lidhje me: (1) Sigurimin se gjuetia lejohet për vetëm një numër të vogël të shpendëve; (2) Fokusin selektiv të zbatuar nga ulja e bllokimit; (3) Monitorimin strikt të kushteve të bllokimit.

Në përgjigjen e tyre drejtuar Komisionit, autoritetet e Maltës kontestuan ankesën e Komisionit dhe insistuan se kushtet për aplikimin e uljes së bllokimit ishin respektuar. Në 2011 Malta gjithashtu ndryshoi uljen e bllokimit në mënyrë që të zbatohet për vetëm një specie, për tushën këngëtare. Komisioni sërish vlerësoi se Malta dështoi në sjelljen e provave të mjaftueshme për të mbështetur kundërshtimet e saj dhe aplikoi uljen e bllokimit, përfshirë të fundit në vjeshtë 2011 në mënyrë jo korrekte. Në këto kushte Komisioni i nisi një opinion të arsyetuar.

5.3 Komisioni Evropian dërgon Bullgarinë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë për dështim në mbrojtjen e specieve në rrezik zhdukjeje¹¹

Rajoni i Kaliakra, i vendosur në bregdetin e Detit të Zi në Bullgari është një vend i rëndësishëm për ruajtjen e llojeve të shumta të shpendëve dhe habitateve të tyre dhe, në përputhje me rrethanat, u caktua një IBA (Zonë e Rëndësishme për Shpendët) nga organizata joqeveritare BirdLife International.

Më 18 dhjetor 2007, në përputhje me Direktivën e Shpendëve, Republika e Bullgarisë përcaktoi Kaliakrën si një ZVM (Zonë e Veçante e Mbrojtur). Sidoqoftë, ajo zonë e mbrojtur përfshinte vetëm dy të tretat e territorit të Kaliakra IBA. Republika e Bullgarisë gjithashtu përcaktoi si ZVM edhe Belite Skali në përfundim të ZVM Kaliakra dhe jashtë IBA Kaliakra. Për më tepër, Bullgaria i propozoi Komisionit që një sipërfaqe Trualli me Interes të Komunitetit (SCI) të ideohet me emrin "Kompleksi Kaliakra" duke përfshirë pothuajse të gjithë zonën e mbuluar nga ZVM-të Kaliakra dhe Belite Skali.

¹⁰ https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-171_en.htm?locale=en

¹¹ https://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-966_en.htm

Pas ankesave të paraqitura nga Shoqata Bullgare për Mbrojtjen e Shpendëve (Bulgarsko Druzhestvo za Zashtita na Ptitsite) në lidhje me shtrirjen e pamjaftueshme të zonës gjeografike të mbuluar nga ZVM Kaliakra dhe efektet e pafavorshme të disa projekteve për biznes në habitatet natyrore dhe habitatet e specieve të shpendëve, Komisioni i dërgoi një njoftim zyrtar më 6 qershor 2008 Bullgarisë duke kërkuar që ajo të shqyrtojë mospërbushjen e detyrimeve të saj sipas nenit 4 (1) dhe (2) të Direktivës së Shpendëve në lidhje me gjashtë zonat ZVM, përfshirë këtu zonën SPA të Kaliakra. Meqenëse Komisioni nuk ishte i kënaqur me përgjigjet e ndryshme të paraqitura nga Bullgaria, ai dërgoi një njoftim zyrtar më 1 dhjetor 2008 duke i kërkuar Bullgarisë të korrigjojë mos përbushjen e detyrimeve të saj sipas nenit 4 (4) të këtij ligji. Direktiva e Shpendëve dhe dispozitat e kombinuara të neneve 2 (1) dhe 4 (2) dhe (3) të Direktivës 2011/92 dhe të Shtojcës III të saj, aq sa Shteti Anëtar kishte autorizuar instalimin e disa turbinave të erës brenda zones IBA së Kaliakra. Bullgaria iu përgjigj këtyre njoftimeve zyrtare më 30 janar 2009 dhe më pas paraqiti informata shtesë në disa raste.

Më 30 shtator 2011, Komisioni dërgoi një njoftim të tretë zyrtar për Republikën e Bullgarisë, e cila, së pari, synonte të konsolidonte dy njoftimet zyrtare të mëparshme dhe së dyti, përmbante kërkesa të reja në lidhje me territoret IBA të Kaliakras, ZVM Belite Skali dhe SCI Kompleks Kaliakra. Ky njoftim ngriti dy grupe çështjesh: hapësirën e pamjaftueshme gjeografike të territorit të ZVM Kaliakra dhe efektet e disa projekteve në ZVM Kaliakra, ZVM Belite Skali, SCI Kompleks Kaliakra dhe zonën që duhej të klasifikohet si ZVM, sipas inventarit të IBA, por që nuk ishte klasifikuar si e tillë.

Më 30 Janar 2012, Bullgaria informoi Komisionin se projektet e listuara prej saj ishin aprovuar, në pjesën më të madhe, përpara hyrjes së këtij Shteti Anëtar në Bashkimin Evropian ose para përfshirjes së zonave në fjalë në rrjetin Natura 2000, dhe si rezultat ligji i BE-së nuk ishte i zbatueshëm për ato zona.

Me njoftimin e 22 qershorit 2012, Komisioni dha një mendim të arsyetuar në të cilin u ankua se Bullgaria kishte dështuar në përbushjen e detyrimeve të saj sipas nenit 4 (1), (2) dhe (4) të Direktivës së Shpendëve, neni 6 (2), (3) dhe (4) të Direktivës së Habitave dhe dispozitave të kombinuara të neneve 2 (1) dhe 4 (2) dhe (3) të Direktivës 2011/92 (Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) dhe të Shtojcës III të saj.

Bullgaria iu përgjigj këtij mendimi të arsyetuar dhe, në bazë të informacionit shtesë, e informoi Komisionin se kishte marrë një seri masash të përcaktuara për të korrigjuar mangësitë e identifikuar.

Ndërsa e vlerësoi situatën si të pakënaqshme, Komisioni ndërmori veprimin e radhës, dërgimin e çështjes në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, në 24 Mars 2014.

Gjykata Evropiane pasi e shqyrtoi çështjen deklaroi se:

- duke mos përfshirë të gjitha territoret e zonave të rëndësishme të shpendëve në zonën e veçantë të mbrojtjes që mbulon rajonin Kaliakra, Republika e Bullgarisë nuk ka arritur të klasifikojë si zona të posaçme mbrojtjeje, territoret më të përshtatshme në numër dhe madhësi për ruajtjen, së pari, të specieve biologjike të listuara në Shtojcën I të Direktivës 2009/147/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 30 nëntorit 2009 për ruajtjen e shpendëve të egër dhe, së dyti, të specieve migratore që nuk janë shënuar në atë aneks, por që levizin rregullisht në ato zona gjeografike e detit dhe tokës ku zbatohet

kjo direktivë, me rezultatin që ai Shtet Anëtar nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 4 (1) dhe (2) të asaj direktive;

- duke miratuar zbatimin e projekteve 'AES Geo Energy', 'Disib' dhe 'Longman Investment' në territorin e zonës së rëndësishme të shpendëve që përfshin rajonin Kaliakra i cili nuk u klasifikua si zonë e veçantë e mbrojtur, megjithëse do të duhej të ishte, Republika e Bullgarisë nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 4 (4) të Direktivës 2009/147;
- duke miratuar zbatimin e projekteve 'Kaliakra Ëind Ëind', 'EVN Enertrag Kavarna' dhe 'Vertikal - Petkov & Cie', dhe 'Thracian Cliffs Golf & Spa Resort', në territorin e zonave të veçanta të mbrojtura në rajonet Kaliakra dhe Belite Skali përkatësisht, Republika e Bullgarisë nuk ka përmbushur detyrimet e saj në bazë të nenit 6 (2) të Direktivës së Këshillit 92/43/KEE të datës 21 maj 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër;
- duke dështuar, së pari, për të vlerësuar si duhet efektin kumulativ të projekteve 'Ëindtech', 'Brestiom', 'Eco Energy' dhe 'Longman Investment' në territorin e zonës së rëndësishme të shpendëve që përfshin rajonin Kaliakra i cili nuk u klasifikua si zonë e veçantë për mbrojtje, megjithëse duhet të ishte cilësuar si e tillë, dhe, së dyti, duke autorizuar zbatimin e projektit 'Longman Investment', Republika e Bullgarisë nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 4 (2) dhe (3) të Direktiva 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 13 dhjetorit 2011 për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin dhe pikën 1 (b) të Shtojcës III të asaj direktive, dhe sipas nenit 2 (1) të asaj direktive, përkatësisht;¹²

5.4 Komisioni Evropian paralajmëron Greqinë për mangësitë në mbrojtjen e natyrës¹³

Komisioni Evropian paralajmëron në mënyrë të përsëritur Greqinë për dy dështime në zbatimin e legjislacionit të biodiversitetit në një mënyrë të pritshme. Greqia është dërguar më parë në gjykatë për mos përcaktimin e një numri të mjaftueshëm të zonave të mbrojtura për shpendët, dhe për mos sigurimin e mbrojtjes së duhur për ato zona që janë caktuar. Gjykata gjeti mangësi të shumta, shumica prej të cilave ende nuk janë zgjidhur. Dështimet e mëtejshme për të adresuar këto probleme mund të nënkuptojë një paraqitje tjetër në gjykatë dhe përfundimisht ndëshkim me sanksione financiare. Komisioneri i Mjedisit të BE, Janez Potočnik, u shpreh: *"Presioni mbi biodiversitetin e Evropës nuk ka qenë kurrë më intensiv. Të gjitha Shtetet Anëtare duhet të bëjnë çmos për të ruajtur habitatet tona natyrore. Greqia duhet të zbatojë plotësisht legjislacionin e Evropës Natura 2000 para se të jetë vonë."*

Pas përfundimit të një çështje që datonte nga viti 1998, Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi kundër Greqisë më 25 tetor 2007 për dështimin e saj për të caktuar një numër të mjaftueshëm të Zonave të Veçanta të Mbrojtjes (ZVM) për shpendët e egër. Gjykata renditi mangësi të shumta dhe identifikoi dymbëdhjetë specie në nevojë të veçantë për mbrojtje më të fortë, duke përfshirë edhe *Gypætus barbatus*, një specie e rrezikuar dhe Shqiponja Perandorake (*Aquila heliaca*), një specie e përshkruar si e kërcënuar. Greqia më pas shtoi edhe 12 ZVM të tjera, duke e çuar numrin total në 163 të ZVM kombëtare, dhe caktoi zona të mjaftueshme për njërin prej llojeve të përmendur posaçërisht në vendimin e Gjykatës. Përkundër këtij përparimi të

¹²<http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=173520&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=1337115>

¹³https://europa.eu/rapid/press-release_IP-10-310_en.htm?locale=en

kufizuar, mbulimi i përgjithshëm mbetet shumë më pak se kërkesat e gjykatës. Rreth 32 Zonat e Rëndësishme të Shpendëve (IBA) ende nuk janë mbuluar nga ZVM-të, dhe mbulimi i 67 IBA-ve të tjera është i pamjaftueshëm dhe kufijtë do të duhen rishikuar. Prandaj Komisioni dërgoi një paralajmërim përfundimtar me shkrim për pasojat e mundshme të këtyre dështimeve, të cilat përfundimisht mund të përfshijnë një ndëshkim financiar për Greqinë.

Një paralajmërim i veçantë po dërgohet gjithashtu në lidhje me dështimin e tij për të vendosur dhe zbatuar një regjim ligjor koherent, specifik dhe të plotë i cili do të garantonte një menaxhim të qendrueshëm dhe një mbrojtje efikase të ZVM-ve që janë caktuar tashmë. Gjykata Evropiane vendosi kundër Greqisë në Dhjetor 2008, duke vënë në dukje se ajo me të vërtetë nuk po mbronte ZVM-të ekzistuese në një mënyrë të përshtatshme. Një përparim i vogël është bërë që nga ajo kohë dhe Komisioni është i bindur për seriozitetin e shkeljes dhe vonesa nuk mund të vazhdojë. Prandaj, një paralajmërim me shkrim për pasojat e mundshme të mosrespektimit të aktvendimit u dërgua.

5.5 Komisioni i kërkon Hungarisë të respektojë legjislacionin e BE-së për vlerësimet e ndikimit në mjedis¹⁴

Komisioni Evropian i kërkoi Hungarisë që të përshtaste legjislacionin e saj kombëtar për vlerësimin e efekteve të projekteve në mjedis në përputhje me rregullat e BE-së. Me rekomandimin e Komisionerit të Mjedisit, Janez Potočnik, Komisioni dërgoi një mendim të arsyetuar për këtë çështje. Në mungesë të një përgjigje të kënaqshme brenda dy muajve, Komisioni mund ta dërgonte çështjen në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.

Një objektiv themelor i Direktivës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Direktiva e VNM) është të sigurojë që projektet që kanë të ngjarë, për shkak të natyrës, madhësisë ose vendndodhjes së tyre, të kenë efekte të rëndësishme në mjedis, t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndikimit në mjedis. Në Hungari, Direktiva e VNM-së ishte implementuar gabimisht në ligjin kombëtar, veçanërisht në lidhje me procesin e shqyrtimit të projektit i cili përcakton nëse disa projekte të listuara në Shtojcën II të Direktivës duhet të kenë një VNM. Ligji hungarez vendosi disa kufij dhe kritere të përjashtimit të cilat nuk morën parasysh të gjitha kriteret përkatëse të përzgjedhjes të përcaktuara në Shtojcën III të Direktivës. Kjo rezultoi në një zbatim të kufizuar të Direktivës.

Kjo çështje u adresua fillimisht me një letër zyrtare njoftimi dërguar Hungarisë në maj 2009, e ndjekur nga një tjetër letër shtesë në janar 2010. Ndërkohë Hungaria ka miratuar një numër ndryshimesh legjislative për të siguruar përputhjen me kërkesat e Direktivës. Komisioni i mirëpriti këto ndryshime, por vuri në dukje se mangësitë ende mbesnin në lidhje me shqyrtimin e një sërë projektesh.

6. AKSESI NË DREJTËSI. PRAKTIKA TË MIRA DHE RASTE SUKSESI

Aksesi në drejtësi për çështjet mjedisore është një e drejtë që garantohet nga Konventa e Aarhus, e ratifikuar nga të gjithë vendet e rajonit, përfshirë Shqipërinë, me qëllimin për të përmirësuar demokracinë mjedisore.

¹⁴ https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-656_en.htm?locale=en

Pjesë të legjislacionit të BE-së dhe shumë çështje gjyqësore të Gjykatës Evropiane për Drejtësi, sigurojnë aksesin në gjykatë deri në një nivel, por një gjë e tillë nuk aplikohet dhe respektohet njësoj në të gjithë BE-në dhe më pak respektohet ajo nga vendet jashtë BE-së, edhe pse kandidatet për anëtarësim si vendi ynë dhe në përgjithësi vendet e Ballkanit perëndimor.

Në vijim japim një pasqyrë të shkurtër se si kjo pjesë e legjislacionit është reflektuar në vende të ndryshme të BE, të shtrira gjeografikisht pranë rajonit.

6.1 Praktikë legjislative të aksesit në gjykatë në vende të ndryshme

6.1.1 Sllovakia

Ligji Slovak nuk parashikon në mënyrë specifike mundësinë e kërimit të rishikimit të një plani të rregullimit të territorit ose vendime të tjera që prekin mjedisin, por prokurori ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për anulimin e këtyre akteve nëse pretendon paligjshmërinë e tyre.

Njësoj legjislacioni aktual në Sllovaki nuk përcakton në mënyrë eksplicite që publiku ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar rishikimin e Vendimit të Shqyrtimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM-së). Konsiderohet se shqyrtimi i VNM-së nuk është pjesë e procedurës administrative ndaj dhe është shumë e diskutueshme nëse publiku mund të pretendojë se e drejta e tij është mohuar nga shqyrtimi i VNM-së. Por lejet administrative të lëshuara në bazë të deklaratës përfundimtare të VNM, (si lejet mjedisore) mund të rishikohen nga gjykatat. Gjykata gjithashtu mund të rishikojë ligjshmërinë e dokumenteve, mbi të cilat është bazuar leja, pra edhe ligjshmërinë e vendimit përfundimtar të VNM-së. Nëse gjykata e konsideron këtë të fundit si të paligjshëm, ajo gjithashtu duhet të revokojë edhe lejen e dhënë. Gjykatat shqyrtojnë ligjshmërinë procedurale dhe thelbësore të vendimeve përfundimtare të VNM-së. Rishikimi i tyre, i gjetjeve materiale dhe teknike dhe llogaritjet dhe saktësia e ekspertëve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është sidoqoftë i kufizuar. Nga ana tjetër, gjykatat shqyrtojnë nëse autoriteti respektiv i ka trajtuar në mënyrë të kënaqshme kundërshtimet e pjesëmarrësve për korrektësinë dhe saktësinë e gjetjeve dhe llogaritjeve materiale dhe teknike dhe llogaritjen dhe saktësinë e ekspertit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Legjitimimi para gjykatave kombëtare u jepet OJF-ve dhe personave të tjerë, të cilët paraqesin komente në fazën e konsultimit publik të procedurës së VNM-së. Kështu, këta persona bëhen pjesëmarrës në procedurën e lejes administrative dhe vetëm pjesëmarrësve të procedurës së lejes administrative u jepet status ligjor, sipas legjislacionit Sllovak. Qendrimi para gjykatës u jepet edhe personave, të cilët nuk kanë bërë komente në fazën e konsultimit publik të procedurës së VNM, por janë pjesëmarrës në procedurën e lejes administrative. Gjykata mund të japë një urdhër paraprak, që do të thotë pezullim i zbatimit të vendimit të lejes.¹⁵

Përveç kërkesave kundër vendimit administrativ, një person gjithashtu mund të paraqesë një kërkesë në seksionin administrativ të zyrës së prokurorit publik duke i kërkuar prokurorit publik të paraqesë një të ashtuquajtur “protestë” kundër një vendimi të paligjshëm administrativ. Një ankesë gjithashtu mund të ngrihet kundër një sjellje të paligjshme të autoriteteve publike. Drejtori i zyrës së autoriteteve publike në fjalë zakonisht merret me këtë

¹⁵ https://e-justice.europa.eu/content_access_to_justice_in_environmental_matters-300-sk-en.do?member=1

ankesë. Avokati i Popullit shqyrton kërkesat e qytetarëve që pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre. Nëse kërkesa ka të bëjë me një vendim administrativ të zbatueshëm të autoritetit publik dhe ombudsmani e gjykon të paligjshëm, ai mund ta çojë çështjen te prokurori publik. Ky i fundit mund të bëjë një kërkesë kundër një vendimi të paligjshëm administrativ dhe gjithashtu mund t'i propozojë autoritetit, i cili ka dhënë vendimin, ta revokojë atë. Nëse as ky autoritet dhe as autoriteti i lartë nuk e trajtojnë në mënyrë të kënaqshme kërkesën, prokurori publik mund të paraqesë kërkesë në gjykatë kundër vendimit administrativ të paligjshëm.

Prokurori publik gjithashtu mund të paraqesë një kërkesë në gjykatë kundër mosveprimit të autoriteteve publike nëse këto mbeten joaktive edhe pas njoftimit të prokurorit.

Në çështjet gjyqësore që i përkasin mjedisit, nevojiten ekspertë mjedisorë. Shoqatat mjedisore janë të përjashtuara nga taksat gjyqësore. Në këto lloj çështjesh procedimi mund të fillojë me një kërkesë.

Konkluzion

Legjislacioni Sllovak ofron disa zgjidhje lidhur me aksesin në gjykatë.

- ***Kompetenca të veçanta i janë dhënë prokurorit publik lidhur me kërkesat që i drejtohen gjykatës kundër akteve administrative me efekte në mjedis. Një zgjidhje e tillë ekuilibron vështirësinë e aksesit në gjykatë nga ana e publikut (organizatave të shoqërisë civile, etj.) me kontrollin që duhet t'i bëhet dhe i bëhet aktivitetit të administratës publike në funksion të zhvillimit të projektve me ndikim në mjedis. Kujtojmë se ky aktivitet nëse nuk mund të kontrollohet nga publiku, siç ndodh në vendet e Ballkanit, mes aksesit në gjykatë mbetet pa kontroll duke cenuar edhe ruajtjen e balances se pushtetve përmes parimit check and balance.***
- ***Legjitimimi para gjykatave kombëtare u jepet OJF-ve dhe personave të tjerë, të cilët paraqesin komente në fazën e konsultimit publik të procedurës së VNM-së. Kështu, këta persona bëhen pjesëmarrës në procedurën e lejes administrative dhe vetëm pjesëmarrësve të procedurës së lejes administrative u jepet status ligjor, sipas legjislacionit Sllovak.***
- ***Organizatat mjedisore janë të përjashtuara nga taksat gjyqësore***

6.1.2 Kroacia

Baza ligjore për transpozimin e Konventës së Aarhusit në legjislacionin kombëtar në Kroaci është ligji për mbrojtjen e mjedisit. Përafrimi i dispozitave të Konventës në legjislacionin kombëtar u bë gjithashtu në ligje dhe akte nënligjore të tjera specifike si: ligji mbi të drejtën e aksesit në informacion, ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ligji për Mosmarrëveshjet Administrative, Rregulloren për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të planeve dhe programeve, Rregullorja e sistemit të informacionit mjedisor.

Ligji për gjykatën administrative lejon disa nisma qytetare (një grup individësh, OJF-të) që preken nga disa leje ndërtimi, plane vendore ose nga deklarata e VNM-së për të filluar një mosmarrëveshje administrative kundër një vendimi të tillë. Këtë të drejtë gëzohet edhe kur ato nuk kufizohen drejtpërdrejt me pronën për të cilën po bëhet plani vendor ose leja e ndërtimit, pasi një vendim i tillë (akti administrativ) do të ketë ndikim në mjedisin e tyre dhe cilësinë e jetës së tyre, kjo do të thotë se me këtë vendimmarrje cenohet e drejta e tyre e veçantë.

Ligji për mbrojtjen e mjedisit ofron përkufizime të "publikut" dhe "publikut të interesuar". "Publiku" përcaktohet si një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, grupet, shoqatat dhe organizatat e tyre në përputhje me rregulloret dhe praktikë të veçantë.

"Publik i interesuar" është publiku i cili preket ose ka gjasë t'i preket ambienti nga vendimmarrja dhe e cila jeton ose punon në një zonë ku ka ose ka mundësi të ketë efekte të pafavorshme mjedisore.

Organizatat e shoqërisë civile, të cilat janë aktive në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe plotësojnë të gjitha kërkesat në përputhje me ligjin, do të konsiderohet se janë palë të interesuara. Ligji për mjedisin konsideron se një organizatë e shoqërisë civile që promovon mbrojtjen e mjedisit ka një interes të mjaftueshëm juridik në procedurat e rregulluara nga ky ligj, nëse plotëson kërkesat e mëposhtme:

- është regjistruar në përputhje me rregulloret e veçanta që rregullojnë veprimtarië e këtyre organizatave dhe nëse mbrojtja dhe promovimi i mjedisit, përfshirë mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njeriut ose përdorimit racional të burimeve natyrore, përcaktohet si qëllim në statutin e organizatës;
- është regjistruar për të paktën dy vjet para fillimit të pjesëmarrjes së publikut në procedura e autoritetit publik dhe mund të vërtetojë se në atë periudhë ka marrë pjesë aktive në aktivitete në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në territorin e qytetit ose bashkisë ku ka selinë e regjistruar në përputhje me Statutin.

Konkluzion

Legjislacioni Kroat pranon legjitimitimin e organizatave mjedisore në procese gjyqësore kundër akteve administrative me ndikim në mjedis pas përmbushjes së disa kriterëve të veçanta si regjistrimi i tyre, përfshirja në çështjet mjedisore dhe ato të zhvillimit të qendrueshëm, në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre sipas statutit, për një kohëzgjatje prej dy vjetësh para nxjerrjes së aktit administrative të cilin kundërshtojnë.

6.1.3 Estonia

Në ligjet estoneze nuk ka kërkesa për legjitimitimin e OJF-ve, prandaj gjykatat e kanë interpretuar legjitimitimin mjaft gjerësisht. Legjitimitim i është dhënë nga gjykatat në disa raste drejtpërdrejt organizatave jofitimprurëse dhe fondacioneve, qëllimet statutores të të cilave përfshijnë mbrojtjen e mjedisit. Gjykata Supreme ka deklaruar se "nuk ka nevojë për rregulloret speciale për legjitimitimin në legjislacionin kombëtar. Legjitimitimi lejohet për kundërshtimin e vendimeve, akteve ose mosveprimeve, në bazë të dispozitave të Konventës, në rast se një vendim, akt ose mosveprim i tillë është i diskutueshëm në gjykatë sipas ligjit kombëtar".¹⁶

Praktika gjyqësore estoneze zbaton Konventën e Aarhusit drejtpërdrejt dhe mban qëndrimin se OJF-të mjedisore nuk kanë detyrim të provojnë dëmtimin e të drejtave, ose interesin e mjaftueshëm të tyre.

¹⁶ Vendimi I Gjykatës së Lartë nr 3-3-1-81-03, 29 janar 2004 (Estonian Green Movement kundër Ministrisë së Çështjeve Ekonomike)

Deri më tani, gjykatat kanë legjitimuar OJF-të si persona juridikë vetëm në bazë të faktit që OJF-të kanë në fushën e veprmtarisë së tyre mbrojtjen e mjedisit. Arsyeja e mos përcaktimit të më shumë kriterëve ka të ngjarë të vjë pasi që OJF-të në fjalë kanë pasur aktivitete të njohura mjedisore, kështu që gjykatat nuk janë shqetësuar të analizojnë më thellë çështjen e legjitimitit të tyre.¹⁷

Për më tepër, legjitimim u është dhënë grupeve lokale aktiviste që nuk janë persona juridikë, por të ashtuquajturat "partneritete". "Partneriteti" është një term që vjen nga Ligji i Detyrimeve, i cili përcaktohet si situatë kur *"dy ose më shumë persona (partnerë) marrin përsipër të veprojnë për të arritur një objektiv reciprok dhe për të ndihmuar në arritjen e objektivit në mënyrën e përcaktuar me kontratë, duke dhënë kontribute"*. Për një situatë të tillë, Gjykata Supreme, megjithatë, ka vendosur kriterë të caktuara të qëndrimit - një grup joformal mund të konsiderohet një formë organizimi joqeveritar mjedisor nëse vërteton se përfaqëson pozicionin e një pjese të rëndësishme të popullsisë lokale.¹⁸

Së dyti, në planifikimin hapësinor, ekziston de fakto institute i *actio popularis*¹⁹ - planet hapësinore mund të diskutohen në gjykatë nga kushdo, të drejtat e të cilit janë shkelur ose dikush që konstaton se plani nuk është në përputhje me ligjin. Lidhur me këtë ekziston një dispozitë e veçantë, në Aktin e Planifikimit Hapësinor. Sidoqoftë, ky akt nuk vepron për të të gjitha lejet mjedisore, sepse jo të gjitha aktivitetet që mund të ndikojnë mjedisin duhet të përfshihet në planin hapësinor (për shembull, nuk ka asnjë detyrim për planifikimin hapësinor në pyjet dhe lejet minerare ose disa leje të përdorimit të ujit).

Lidhur me grupet e individeve, Gjykata Supreme arsyetoi në një vendimi të saj se *"grupi informal mund të konsiderohet si anëtar i publikut që ka legjitimim, vetëm në rast se pozicionimi i grupit koincidon me përfaqësimin dhe mbrojtjen e një aktiviteti konkret apo habitati të veçantë"*.²⁰ Në atë çështje statusi i përfaqësuesve të publikut u fitua nga një grup individësh, pasi provuan me mbledhjen e 2483 firmave në nënshkrimin e peticionit për mbrojtjen e troftës.

Konkluzion

1. Në ligjet estoneze nuk ka kërkesa për legjitimimin e OJF-ve, por praktika gjyqësore estoneze zbaton Konventën e Aarhusit drejtpërdrejt dhe mban qëndrimin se OJF-të mjedisore nuk kanë detyrim të provojnë dëmtimin e të drejtave, ose interesin e mjaftueshëm të tyre).

2. Në planifikimin hapësinor, ekziston de fakto instituti i actio popularis - ku planet hapësinore mund të diskutohen në gjykatë nga kushdo, të drejtat e të cilit janë shkelur ose dikush që konstaton se plani nuk është në përputhje me ligjin.

3. Grupet e individeve, edhe pse jo të organizuar formalisht, mund të çojnë çështje para gjykatës nëse provojnë aktivizim në çështjen për të cilën ngrenë padi.

¹⁷ Disa kriterë janë përfshirë në ligjin për mjedisin në 2011, sipas të cilit një organizatë jofitimprurëse do të jetë një organizatë mjedisore nëse ka për qëllim statutor mbrojtjen e mjedisit dhe ka kryer aktivitete në mbrojtje të mjedisit. Për të vlerësuar këtë të fundit meren parasysh kapaciteti i organizatës, duke përfshirë aktivitetet aktuale të saj, kriteret për anëtarësinë, nëse nuk ka aktivitete aktuale atëherë merren parasysh struktura organizative, numri i anëtarëve dhe kriteret për anëtarësinë.

¹⁸ I njëjti qëndrim përdoret në përkufizimin e "organizatave mjedisore" në ligjin për mbrojtjen e mjedisit (2007).

¹⁹ Actio popularis është një term latin që do të thotë: ngritja e padisë nga një palë e tretë në interes të publikut.

Ky term rrjedh nga ligji penal romak. Shih: <https://definitions.uslegal.com/a/actio-popularis/>

²⁰ Vendimi I Gjykatës së Lartë në çështje me nr 3-3-1-43-06, 28 Nëntor 2006

6.1.4 Rumania

Akti i Procedurës Administrative i 2004 i jep statusin në të gjitha procedurat administrative të gjithë organizmave shoqërore që synojnë të mbrojnë të drejtat themelore sipas statutit të tyre. Një ligj i ri për mbrojtjen e mjedisit u miratua në vitin 2005²¹, i cili njihet *actio popularis* në të gjitha çështjet mjedisore, për personat e tjerë, drejtpërdrejt ose përmes OJF-ve mjedisore, përfshirë të drejtën për t'u këshilluar në procesin e vendimmarrjes, për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit mjedisor, për nxjerrjen e akteve normative dhe gjithashtu për planet dhe programet.²²

Legjislacioni sekondar ka përcaktuar procedura specifike për aksesin në drejtësi në çështjet mjedisore.

Ligji i Gjykatës Administrative, 2004, gjithashtu përfshin në kategorinë e personave që mund t'i drejtohen me padi gjykatës, organizatat shoqërore, të cilat kanë pasoja nga dokumenti administrativ i kontestuar ose kur cenohet një interes publik, ose i të drejtave dhe interesave të ligjshëm të personave. Interesi publik i referohet rendit të drejtësisë dhe demokracisë kushtetuese, garancisë së të drejtave themelore. Meqenëse e drejta mjedisore paraqet një të drejtë themelore sipas nenit 35 të Kushtetutës konsiderohet se ligji administrativ jep një tolerancë më të madhe ndaj aksesit në drejtësi në lidhje me problemet mjedisore, duke mos kufizuar organizatat joqeveritare që mund të kundërshtojnë dokumentet që sjellin ndikim në mjedis vetëm për ato organizata që kanë si qëllim mbrojtjen e mjedisit.

Në këtë mënyrë, aktet normative të përmendura shprehen qartë për mundësinë e organizatave jofitimprurëse të kundërshtojnë në gjykatë akte dhe veprimtari që cenojnë mbrojtjen e mjedisit.

Si rezultat, e gjithë jurisprudenca në Rumani mban qendrimin se çdo person dhe të gjitha OJF-të, mund t'i drejtohen gjykatës për të mbrojtur të drejtat mjedisore ose njerëzore.

Në këto çështje nuk ka asnjë kërkesë të vecantë që i referohet legjitimitit. Si rregull i përgjithshëm, për të pasur akses, paditësi duhet të dëshmojë shkelje subjektive të të drejtave të tij. Ndërsa, në çështjet mjedisore të gjitha rastet lehtësisht mund të gjykohen sipas ligjit procedural.

Konkluzion

Rumania është një nga vendet me legjislacionin më të mirë në rajon sa i takon legjitimitit aktiv të organizatave jofitimprurëse dhe padive kolektive në çështjet mjedisore. Këto padi janë rregulluar nga Ligji procedural dhe Gjykatat vendase pranojnë lehtësisht gjykimin e padive me objekt mbrojtjen e mjedisit.

²¹ Urdhëresë Qeveritare, nr.195/2005

²² Ligji 195/2005 në lidhje me mbrojtjen e mjedisit përcakton në nenin 5 se: për këtë çështje: a) qasja në informacionin e mjedisit, në përputhje me kushtet e konfidencialitetit të përcaktuara me legjislacionin efektiv; b) shoqata në organizatat e mbrojtjes së mjedisit; c) konsulencë brenda procesit të marrjes së vendimeve në lidhje me zhvillimin e politikës dhe legjislacionit mjedisor, lëshimin e dokumenteve rregulluese në terren, përpilimin e planeve dhe programeve; d) e drejta për të apeluar, drejtpërdrejt ose përmes organizatave të mbrojtjes së mjedisit, tek autoritetet administrative dhe / ose gjyqësore, sipas rastit, për problemet mjedisore; e) e drejta për gjykim për dëmet e pësura. ” neni 20 pika 6 e ligjit 195 përcakton se "Organizatat Joqeveritare që promovojnë mbrojtjen e mjedisit kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës për problemet mjedisore".

6.1.5 Sllovenia

Legjislacioni Slloven përcakton kushte mjaft të rrepta për dhënien e aksesit në gjykatë një OJF-je²³, që vepron në interes publik. Ky status mund të merret nga një shoqatë, fondacion ose një institut privat:

- themeluesi i të cilit nuk është shteti, komuna, entiteti tjetër i së drejtës publike ose partia politike;
- ka një numër të mjaftueshëm anëtarësh (në rast të shoqatave, së paku 30 anëtarë), punonjës (në rast të instituteve, të paktën 1 punonjës ekspert me gradë zyrtare nga instituti) kapitali (në rast themelemi, të paktën 1250 EUR);
- është themeluar me qëllim të mbrojtjes së mjedisit;
- është i pavarur nga autoritetet publike dhe partitë politike;
- ka qenë aktiv në fushën e mjedisit për të paktën pesë vjet;
- mban të regjistruara të dhënat (kontabilitetin) e llogarisë së vet;
- është aktiv në të gjithë territorin e Republikës së Sllovenisë, ose të paktën në pesë shtete anëtare në rast se është OJF-ja e që është regjistruar jashtë Sllovenisë.

Akti i mbrojtjes së natyrës në nenin 137 parashikon një kusht të dytë për një OJF që të përfshihet në procedurat administrative dhe gjyqësore në fushën e mbrojtjes së natyrës. Ky akt deklaron se shoqata (përfshijë llojet e tjera të personave juridikë të OJF-ve) mund të fitojë një status të "shoqatës që vepron në interes të publikut" nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

- është aktive në fushën e ruajtjes së natyrës;
- ka fituar njohje, shpërblim ose ndonjë vlerësim tjetër të favorshëm nga ekspertë të njohur ndërkombëtarisht për aktivitetet e tyre në ruajtjen e natyrës;
- siguron të paktën pjesërisht fonde nga tarifat e anëtarësimit;
- shpenzon shumicën e fondeve të saj për ruajtjen e natyrës;
- kontribuon ndjeshëm në ruajtjen e natyrës mes edukimit dhe promovimit;

Në bazë të ankesave të OJF-ve dhe një vendimi gjyqësor këto kushte u zbutën në fillim të Dhjetorit 2009 duke e sjellë Slloveninë më afër dhe në përputhje me Konventën e Aarhusit.

Edhe pse kushtet tani janë më pak të rrepta, ato ende janë të larta për standardet e OJQ-ve Sllovene. Për më tepër, kërkesa e parë për të fituar këtë status u paraqit në Ministrinë e Mjedisit rreth një vit më parë dhe që atëherë e kanë ndjekur shumë të tjera. Gjatë verës 2009 pesë OJF-të e para e morën këtë status. Megjithatë ky mbetet një standard i kritikueshëm në raport me kërkesat e Konventës së Aarhus.

Konkluzion

Legjislacioni Sloven njeh mundësinë e aksesit në gjykatë të organizatave jofitimprurëse, por u ka vendosur atyre kushte të rrepta, duke konsideruar vetëm ato shoqata që janë aktive në fushën e ruajtjes së natyrës, njihen nga ekspertë të njohur ndërkombëtarisht për

²³ Kushte më të detajuara janë përcaktuar në rregullorren kërkesat e detajuara dhe masat për autorizimin e statusit të organizatave jofitimprurëse të cilat kryejnë veprimtarinë në mbrojtje të mjedisit për interes publik, Ur.l. RS št. 112/2006

aktivitetet e tyre, marrin pjesërisht fonde nga tarifat e anëtarësimit dhe shpenzojnë shumicën e fondeve për ruajtjen e natyrës, si dhe kontribuojnë në ruajtjen e natyrës mes edukimit dhe promovimit.

6.2 Çështje nga praktika

Nëse publiku gëzon të drejtën e aksesit në gjykatë, edhe pa qenë një vend anëtar i BE-së, cenimi i mjedisit mund të goditet në rrugë gjyqësore dhe të arrijë sukses. Në Shqipëri ekziston një problem i aksesit në drejtësi, ku pavarësisht se njihet e drejta e publikut për të ngritur një padi mjedisore, ligji për gjykatat administrative krijon pak hapësirë dhe gjykatat në përgjithësi deri tani e kanë interpretuar ligjin në disfavor të publikut.

Në vijim japim dy raste suksesi kur kanë qenë gjykatat vendase, që përmes vënies në lëvizje nga publiku, kanë dhënë vendime të rëndësishme për mjedisin.

6.2.1 Ndalimit i ndërtimit të HEC-eve në Parkun Kombëtar të Mavrovës

Si zona më e pasur e Maqedonisë së Veriut në biodiversitet, Parku Kombëtar Mavrovo raprtohet të jetë shtëpia e llojeve të ndryshme të faunës së mbrojtur rreptësisht nga Konventa e Bernës. Parku Kombëtar Mavrovo është një nga zonat e fundit ku është dëshmuar riprodhimi i rrëqebullit jashtëzakonisht të rrallë të Ballkanit. Ndërtimi i hidrocentraleve dhe infrastruktura përkatëse do të shkatërronte një nga habitatet e tij të fundit. Rrëqebulli i Ballkanit është një specie e rrëqebullit euroaziatik dhe konsiderohet e rrezikuar në mënyrë kritike nga Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Përveç kësaj, parku kombëtar Mavrovo strehon më shumë se 1000 kafshë dhe rreth 1500 specie bimore dhe është një nga pikat e nxehta të biodiversitetit në Evropë. Midis tyre është Rrëqebulli i Ballkanit i rrezikuar në mënyrë kritike me një popullsi të mbetur prej 20-40 individësh.²⁴

Pikërisht në territorin e këtij parku, në vitin 2010 qeveria maqedonase planifikoi ndërtimin e dy hidrocentraleve të mëdha - Boškov Most dhe Lukovo Pole - dhe 20 të vogla. Ndërsa Parku ka dy hidrocentrale të mëdhenj që janë në veprim që nga vitet 1950, të cilët ndikojnë në nivelin e ujit dhe jetën e egër në park. Shtimi i më shumë hidrocentraleve do të kishte një efekt shkatërrues në florën dhe faunën e brishtë të Mavrovës. Për të siguruar financimin e projekteve, u përfshinë dy investitorë ndërkombëtarë: Banka Botërore me një kredi 70 milion USD për Lukovo Pole dhe BERZH me një kredi 65 milion EUR për Boškov Most.

Përpara vendimit për dhënien e kredive duhej bërë një studim i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Sidoqoftë, në nëntor 2011 BERZH miratoi kredinë e saj përpara se të përfundonte procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Pas një ankese të menjëhershme nga organizata mjedisore, Mekanizmi i Ankesave për Projektin e BERZH konfirmoi në 2013 se banka kishte shkelur politikat e veta mjedisore dhe sociale.

Ndërkoh një ankese tjetër u paraqit në 2013 në Konventën e Bernës. Si përgjigje dhe pas hetimit të vet, më 4 dhjetor 2015, Kongresi i Bernës (një nga konventat më të rëndësishme të natyrës në Evropë) i bëri thirrje qeverisë maqedonase të ndalojë të gjitha projektet e ndërtimit brenda parkut kombëtar dhe të bëjë një vlerësim të gjerë të ndikimit në mjedis.

²⁴ <https://bankwatch.org/success-stories/saving-macedonia-s-mavrovo-national-park-and-the-balkan-lynx>

Rekomandimet Berna i drejtoi gjithashtu tek financuesit ndërkombëtarë të projekteve të hidrocentraleve, veçanërisht te BERZH.

Pas këtij rekomandimi brenda të njëjtit muaj, Banka Botërore në 22 dhjetor 2015 tërhoqi fondet e saj për një nga dy projektet e mëdha të hidrocentraleve brenda Parkut Kombëtar Mavrovo në Maqedoninë e Veriut.

Ndërsa përpjekjet për të zhvilluar projektet e ndërtimit të HEC-eve nuk ndaluan, organizata mjedisore iu drejtuan gjykatës administrative vendase, e cila pranoi të shqyrtojë ankesën e paraqitur nga organizata maqedonase e mjedisit *Front 21/42* dhe shpalli të pavlefshme licencën për ndërtimin e projektit të hidrocentraleve. Sipas gjykatës Ministria e Mjedisit e kishte dhënë licencën në vitin 2012 në bazë të një vlerësimi jashtëzakonisht të papërshtatshëm dhe jo të plotë të ndikimit në mjedis dhe për këtë arsye ka shkelur ligjin ekzistues kombëtar të mjedisit. Një vlerësim i shëndoshë i ndikimeve mjedisore nuk u krye kurrë.

Pas akordimit të financimit për dy projektet e mëdha të hidrocentraleve në Parkun Kombëtar Mavrovo, Maqedoni, pasi Banka Botërore ishte tërhequr nga financimi i hidrocentralit 'Lukovo Pole' në dhjetor 2015, në 24 janar 2017 edhe BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) deklaroi të dilte nga projekti "Boskov Most".

Kundërshtimi ndaj zhvillimit të hidrocentraleve në Mavrovo nuk ishte i kufizuar vetëm nga aktivitete të organizatave mjedisore. Në vitin 2014, banorët e Mavrovos dhe Dibrës, si dhe diaspora shqiptare organizuan protesta përpara zyrave të Bankës Botërore në të gjithë botën, duke kërkuar që projekti Lukovo Pole të rrëzohet. Dhe gati 200 shkencëtarë të njohur globalisht nënshkruan një petition drejtuar Kryeministrit të Maqedonisë për të anuluar planet për hidrocentralet në Mavrovo. Siç rezultoi përpjekjet patën sukses së pari e tërheqjen e Bankës Botërore, më pas me pezullimin e huasë nga BERZH dhe më tej me tërheqjen tërësisht të BERZH.

Bankat e mëdha ndërkombëtare janë investitorët kryesorë të bumit të ndërtimit të hidrocentraleve në Ballkan, e cila kërcënon të shkatërrojë lumenjtë e fundit të paprekur të kontinentit tonë. Sipas një studimi të financuar nga organizata jofitimprurëse, Bankëatch, Banka Botërore, BERZH dhe Banka Evropiane e Investimeve (EIB) aktualisht janë duke financuar projekte hidrocentralesh me një total fondesh prej 818 milion €, duke rrezikuar rëndë 30 zona të mbrojtura siç janë parqet kombëtare dhe vendet e Nature 2000.²⁵

Konkluzion

Edhe pse mbështetja financiare për projektet ishte miratuar më herët, lufta në drejtimet e duhura për parkun kombëtar Mavrovo dhe rrëqebullin e shpëtoi atë. Suksesi erdhi si rrjedhojë e:

- ***Shfrytëzimit të mjeteve të akimit në Konventat përkatëse;***
- ***Shfrytëzimit të mjeteve të ankimit në Bankat që financojnë projekte me ndikim në mjedis;***
- ***Njohjes dhe legjitimitit të organizatave mjedisore për aksesin në gjykatë;***
- ***Protestave të organizuara para aktorëve relevantë të përfshirë në proces si Banka, Kryeministria;***
- ***Angazhimit të ekspertëve të fushës dhe shkencëtarëve, të cilët u oranzuan dhe ngritën shqetësimet e tyre mes një peticioni publik.***

²⁵ <https://www.balkanrivers.net/en/tags/mavrovo>

6.2.1 Rasti i turbinave të erës pranë zonave të mbrojtura (Hungari)

Në vitin 2012, një OJF mjedisore i kërkoi organizatës EMLA – Shoqata Hungareze e Menaxhimit të Mjedisit - që të niste një çështje ku zhvilluesi planifikonte të ndërtonte një seri centralesh ere prej 16 turbinash në afërsi të fshatrave Szeleste, Hegyfalú, Górház dhe Répceszentgyörgy në qarkun Vas, në veriperëndimin e Hungarisë. Në veri të vendndodhjes së projektit ishte një sit Natura 2000 ('Répce-mente' HUFH20010) i cili është habitat i Brumbullit të Madh Bricjap, Kunadhes së Stepës, Kastorit Euroaziatik, Barbastelas Perëndimore (lakuriq evropian), etj. Turbinat e planifikuara ishin rreth 250 metra larg zonave të veçanta të ruajtjes dhe 800 metra nga banesat e fshatarëve. Faktorët më të rëndësishëm mjedisorë të përfshirë nga projekti ishin dëmtimi i peizazhit, bezdisja e specieve/habitateve të mbrojtura nga emetimi i zhurmës dhe dridhjes nga turbinat. Dokumentacioni i vlerësimit paraprak u dorëzua nga zhvilluesi në 2010 dhe shpjegoi se megjithëse vendndodhja e planifikuar e turbinave është afër vendeve të Natura 2000 dhe zonave të banuara, këto nuk do të ndikohen. Autoritetet mjedisore u pajtuan me zhvilluesin dhe miratuan rezolutën përfundimtare se projekti nuk do të ketë efekte domethënëse në mjedis, dhe ai mund të nisë pas marrjes së lejes së ndërtimit. Kështu nuk u bë një VNM.

Kërkesë padia u paraqit në vitin 2012, e cila argumentonte se habitatet e specieve të mbrojtura dhe zhurma e pritshme dhe dridhjet e turbinave nuk ishin konsideruar si duhet në dokumentacionin e vlerësimit paraprak. Mendimet e ekspertëve konfirmuan pretendimet se në bazë të dokumentacionit të paplotë autoriteti nuk ishte në gjendje të vlerësonte rëndësinë e ndikimeve të mundshme. Sipas ekspertëve, zona e prekur ishte e vlefshme për mbrojtjen e natyrës dhe peizazhit edhe pse ishte jashtë fushëveprimit të zonës së mbrojtur.

Në Shkurt 2017 Gjykata vendase e pranoi padinë dhe deklaroi se projekti do të ketë ndikime të konsiderueshme në mjedis, prandaj i shfuqizoi vendimet e autoriteteve. Gjykata theksoi se vlerësimi paraprak ishte i pamjaftueshëm në lidhje me vlerësimin e efekteve të dridhjeve dhe zhurmave, për më tepër ndikonte në peizazh. Gjykata urdhëroi autoritetin mjedisor që gjatë procedurës së rishqyrtimit të marrë parasysh faktorët e theksuar nga mendimet e ekspertëve.

Rishqyrtimi u bë në vitin 2015, por zhvilluesi dhe autoriteti mjedisor përsëritën se nuk do të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm në mjedis. Këto akte u goditën sërish në rrugë gjyqësore në vitin 2016 pasi ishin shkelur rregullat e përgjithshme të procedurave administrative, si dhe dispozitat vendase për VNM.

Autoritetet nuk i ishin përmbajtur arsyetimit të vendimit të gjykatës, duke injoruar argumentet e paditësve për emetimin e zhurmës dhe dridhjeve që shqetësonin natyrën dhe speciet në zonat e mbrojtura.

Gjatë gjykimit të dytë, eksperti i emetimit të zhurmës deklaroi qartë se zhurma do të jetë domethënëse për zonën në fjalë. Gjykata e pranoi padinë duke urdhëruar të kryhej një VNM e plotë për projektin.

Autoriteti dhe zhvilluesi kundërshtuan vendimin e gjykatës, por vendimi u la në fuqi.

Duhet theksuar se para vitit 2016, ligji hungarez nuk parashikonte ndonjë dispozitë në lidhje me distancën minimale midis turbinave me erë dhe zonave të ndërtuara. Sidoqoftë, në vitin

2016 hynë në fuqi një sërë rregullash të reja që ndaluan ndërtimin e turbinave me erë në një rreze prej 12.000 metrash nga zonat e banuara apo të mbrojtura. Kjo dispozitë e re zbatohet në procedurat e nisura ose të përsëritura pas hyrjes në fuqi, prandaj, realizimi i projektit në fjalë nuk ishte më i mundur, pasi turbinat ishin planifikuar të vendoseshin në një distance shumë më të vogël nga zonat dhe vendbanimet e përmendura.

Konkluzion

Shoqata arriti të bindte gjykatën në një çështje kundër ndërtimit të turbinave me erë pasi argumentoi mes ekspertizave se habitatet e specieve të mbrojtura dhe zhurma e pritshme dhe dridhjet e turbinave nuk ishin konsideruar si duhet në dokumentacionin e vlerësimit paraprak, ndaj në bazë të dokumentacionit të paplotë autoriteti nuk ishte në gjendje të vlerësonte rëndësinë e ndikimeve të mundshme. Sipas ekspertëve, zona e prekur ishte e vlefshme për mbrojtjen e natyrës dhe peizazhit edhe pse ishte jashtë fushëveprimit të zonës së mbrojtur. Gjykata theksoi se vlerësimi paraprak ishte i pamjaftueshëm në lidhje me vlerësimin e efekteve të dridhjeve dhe zhurmave, për më tepër ndikonte në peizazh.

Njëkohësisht ndërtimi i turbinave me erë është rregulluar pas vitit 2016 mes rregullash të përcaktuara që ndalojnë ndërtimin e turbinave me erë në një rreze prej 12.000 metrash larg zonave, një praktikë e mirë kjo për t'u huazuar dhe përshtatur në legjislacionin shqiptar.

7. KONKLUZIONE & REKOMANDIME

- 1) Të gjithë vendet e rajonit kanë nënshkruar Konventën Evropiane të Peisazheve (Firence, 2000 – Këshilli i Evropës). Shqipëria ende nuk e ka nënshkruar këtë Konventë. Ajo paraqet rëndësi në çështjet e mbrojtjes së peisazhit natyror dhe nënshkrimi i saj do të ndihmonte të mbronte sitet natyrore të cilat kanë rëndësi për peizazhin që ofrojnë dhe për monumentet natyrore e kulturore. Ndërkohë një nga shqetësimet e ngritura shpesh në çështjet mjedisore në Shqipëri, por edhe në Ballkanin perëndimor, është cenimi i peisazheve natyrore nga ndërtimet, sidomos në zonat e bregdetit.
- 2) Direktiva Evropiane e Shpendëve është përafruar pjesërisht me legjislacionin kombëtar (së fundi me ligjin nr. 46/2019). Rekomandohet përafrimi tërësisht i legjislacionit me këtë Direktivë.
- 3) Në rajon, në përgjithësi zonat e mbrojtura administrohen nga organe shtetërore, por nuk mungojnë në rajon edhe praktika të tjera, si për shembull administrimi nga OJF. Në Kroaci, menaxhimi i peizazhit të rëndësishëm të Gajnës i është besuar një OJF-je. Në Gajna, OJF dhe Këshilli lokal e menaxhojnë zonën në bashkëpunim dhe përbën një nga rastet e suksesshme të qeverisjes së ndarë me publikun. Në Slloveni konstatohet se në administrim është thirrur edhe komuniteti lokal, pavarësisht se i paorganizuar në OJF.
- 4) Lidhur me monitorimin dhe informacionin mjedisor, vendet e rajonit kanë praktika të ndryshme. Nga praktikatat e mira vlen për t'u përmendur ajo e Kroacisë e cila ka disa regjistra dhe një pjesë e mirë e të dhënave janë të hapura për publikun. Kroacia zbaton

mirë Direktivën 2007/2/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 mars 2007 "Për ngritjen e një infrastrukture për informacionin hapësinor në Komunitetin Europian (INSPIRE)". Shqipëria ka bërë përpjekje për të përafruar këtë direktivë me anën e ligjit nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë". Megjithatë, ky ligj ka përafruar direktivën vetëm pjesërisht dhe në portalin e ASIG vihet re se mungojnë të dhëna të rëndësishme sipas përcaktimeve të direktivës. Nevojitet përafrimi i plotë i legjislacionit tonë me këtë direktivë.

- 5) Nevojitet rishikimi i ligjit nr. 10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e konflikteve administrative", në ato pjesë që pamundëson aksesin e plotë për publikun dhe OJF-të për çështje mjedisore.
 - a. Vendet e rajonit që nuk kanë pengesa të tilla arrijnë të zgjidhin në rrugë gjyqësore rastet duke arritur sukses. Shembull është rasti i shoqatës hungareze që arriti të bindte gjykatën në një çështje kundër ndërtimit të turbinave me erë që me zhurmën dhe dridhjet e tyre cenonin habitatin në zonën e mbrojtur. Gjithashtu, në Maqedoninë e Veriut, shoqëria civile ndaloi ndërtimeve e HEC-eve në një aksion të kombinuar, ku përveç ankesës para organeve ndërkombëtare (Konventa e Bernës), përdori me sukses edhe padinë në gjykatën vendase.
 - b. Në Rumani madje lejohet *actio popularis* si mjet i publikut për të ngritur në gjykatë çështje mjedisore. Rumania është një nga vendet me legjislacionin më të mirë në rajon sa i takon legjitimitetit aktiv të organizatave jofitimprurëse dhe padive kolektive në çështjet mjedisore.
 - c. Shembuj të legjislacioneve të tjerë tregojnë rastet kur shteti ka vendosur disa kritere, por ato nuk duhet të jenë penguese. Madje në Estoni, edhe grupet e individëve edhe pse jo të organizuar formalisht mund të çojnë çështje para gjykatës nëse provojnë aktivizim në çështjen për të cilën ngrejnë padi.
- 6) Në Sllovaki OJF-të mjedisore përjashtohen nga taksat e padive, duke ulur kështu kostot gjyqësore dhe lehtësuar procesin. Një gjë e tillë është e rekomandueshme të bëhet edhe në vendin tonë përmes ndërhyrjeve në ligjin për tarifat e padisë, apo në aktet ligjore përkatëse të miratuara nga Ministri i Drejtësisë. Gjithashtu në Sllovaki i janë kompetenca të veçanta prokurorit, i cili mund të kërkojë shfuqizimin e akteve administrative që cenojnë mjedisin.
- 7) Rast i mirë për t'u marrë shembull është ai i Hungarisë që prej vitit 2016 ka përcaktuar me ligj se ndalohet ndërtimi i turbinave me erë në një rreze 12.000 metra rreth zonave të banuara dhe atyre të mbrojtura. Do të ishte e rekomandueshme që kritere të tilla për largësinë e investimeve të kësaj natyre nga zona të mbrojtura, etj të vendoseshin me ligj edhe në legjislacionin shqiptar.
- 8) Një mënyrë alternative e kundërshtimit të investimeve me ndikim negativ në mjedis është edhe sfidimi i bankave kredidhënëse. Rasti i çështjes së mbrojtjes së Parkut Kmbëtar të Mavrovos në Maqedoninë e Veriut është një shembull i mirë i sukseshëm në këtë kontekst.

- 9) Aksionet ligjore kërkojnë domosdoshmërisht organizim të eksepertëve dhe shkencëtarëve dhe përfitimin e ekspertizave të tyre, pa të cilat një çështje nuk mund të ketë sukses në gjykatë, apo edhe në advokimin publik.

* * *

8. BIBLIOGRAFIA

1. R. Lazarus, The Making of Environmental Law (Cambridge Press 2004); P. Gates, History of Public Land Law Development.
2. Lakshman D Gurusamy, International Environmental Law in a Nutshell (Eest, 5th ed, 2017).
3. Direktiva 79/409/EEC
4. Direktiva 2009/147/EC
5. Direktiva 92/43/EEC
6. Vendimi i Gjykatës së Lartë Estoneze nr 3-3-1-81-03, 29 janar 2004 (Estonian Green Movement kundër Ministrisë së Çështjeve Ekonomike)
7. Vendimi i Gjykatës së Lartë Rumune në çështje me nr 3-3-1-43-06, 28 Nëntor 2006
8. Urdhëresë Qeveritare Rumune, nr.195/2005
9. Ligji rumun 195/2005 në lidhje me mbrojtjen e mjedisit
10. Rregullore (Sloveni) “Për kërkesat e detajuara dhe masat për autorizimin e statusit të organizatave jofitimprurëse të cilat kryejnë veprimtarinë në mbrojtje të mjedisit për interes publik” 112/2006
11. Kus Veenvliet and Sovinc, 2009
12. “Green topics in Western Balkans”, publikuar nga Civil Society Forum of the Western Balkan Summit Serie, s May 2018, https://ëb-csf.eu/docs/Green_Topics.pdf
13. https://europa.eu/rapid/press-release_IP-10-310_en.htm?locale=en
14. https://europa.eu/rapid/press-release_IP-10-310_en.htm?locale=en
15. https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-171_en.htm?locale=en
16. https://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-966_en.htm
17. <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=173520&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=1337115>
18. https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-654_en.htm?locale=en
19. https://europa.eu/rapid/press-release_IP-10-310_en.htm?locale=en
20. <https://www.balkanrivers.net/en/tags/mavrovo>
21. https://e-justice.europa.eu/content_access_to_justice_in_environmental_matters-300-sk-en.do?member=1
22. https://www.sogde.org/ëp-content/uploads/2018/12/benes_iris_kosovo_10_18.pdf
23. https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-539_en.htm?locale=en
24. https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-656_en.htm?locale=en
25. <https://bankwatch.org/success-stories/saving-macedonia-s-mavrovo-national-park-and-the-balkan-lynx>